



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS GLLOGOC**

Numri i lëndës: 2022:196929

Datë: 27.12.2023

Numri i dokumentit: 05130566

**PPP. nr. 227/2020**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEGA NË GLLOGOC-Departamenti i Përgjithshëm**, Gjyqtari Astrit Gashi me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Remzi Duli, në çështjen juridike përbarimore të kreditorit **K... SH.P.K**, në Prishtinë, kundër debitorit **E.C** nga Gllogoci, lidhur me borxhin në vlerë prej **1795.00 €**, duke vendosur në prapësimin e ushtruar nga debitori kundër urdhërit për lejimin e përbarimit të Përbaruesit privat **V.B** nën shenjën P. nr... të datës 24.09.2020, jashtë seancës me datë 27.12.2023 e mori këtë:

**A K T V E N D I M**

- I. APROVOHET** si i bazuar prapësimi i debitorit E.C nga Gllogoci, i ushtruar kundër urdhërit të përbaruesit Privat V.B, P. nr... të datës 24.09.2020 me të cilën është lejuar propozimi për përbarimin e borxhit në bazë të faturës në shumën prej 1795.00 Euro ndaj Kreditorit K... në Prishtinë.
- II. SHFUQIZOHET** Urdhëri P. nr... i datës 24.09.2020 për përbarim i Përbaruesit Privat–Zyrës Përbarimore V.B nga Prishtina.

**ARSYETIM**

Kreditori K... SH.P.K -Prishtinë ka parashtruar propozim te Përbaruesi Privat V.B nga Prishtina, për lejimin e përbarimit në bazë të Dokumentit Besueshëm – Faturës me nr... të datës 12.02.2020 lidhur me pagesën e borxhit kryesor në lartësi prej 1795.00 €, me kamatë vjetore prej 8 %, si dhe shpenzimet e procedurës, të gjitha këto në afat 7 ditor në të kundërtën, të bllokohen llogaritë bankare të debitorit, e nëse nuk ka mjete në llogari të bëhet regjistrimi, sekuestrimi, vlerësimi dhe shitja e sendeve të luajshme dhe të paluajshme e mjetet e mbledhura të derdhen në llogari të kreditorit.

Përbaruesi Privat V.B nga Prishtina, duke vepruar sipas propozimit për përbarim të kreditorit, ka lëshuar urdhër me të cilin ka lejuar përbarimin në bazë dokumentit të besueshëm të Faturës me shenjën nr... të datës 12.02.2020.

Debitori ka paraqitur prapësim kundër urdhrorit për lejimin e përmbarimit në afatin ligjor, për shkak se dokumenti përmbarues me të cilin është iniciuar procedura përmbarimore, nuk i plotëson kushtet në kuptim të Nenit 29 par.1 pika 1.3 të LPP-se ngase fatura nuk i plotëson kushte ligjore për përmbarim, tutje thekson se asnjëherë fatura në bazë të cilës kreditori ka ushtruar propozim për përmbarim nuk i është dorëzuar personalisht debitorit, po ashtu propozimi për përmbarim është i pa vlefshëm për shkak se është paraqitur pas kalimit të gjitha afateve ligjore dhe kreditori e ka humbur të drejtën e kërkesës për shkak të parashkrimit absolut duke u bazuar në Nenin 353 të LMD-së, andaj ka kërkuar që në vështrim të Nenit 73 par. 1 të LPP-së të aprovoj si i bazuar prapësimi i tij dhe të refuzohet si i pa bazuar urdhëri për përmbarim i përmbaruesit privat. Debitori ka parashtruar prapësimin edhe me arsyetimin se borxhi me të cilën ngarkohet nuk ekziston fare pasi që debitori asnjëherë nuk është njoftuar për ekzistimin e një borxhi të tillë-nuk e ka pranuar e-mailin dhe as faturën, dhe se që nga viti 2014 nuk ka raporte me kreditorin, dhe sipas Ligjit **ka arritur parashkrimi**, andaj ka kërkuar nga gjykata që të aprovoj prapësimin në tërësi si të bazuar, dhe të anulohet urdhëri përmbarimor.

Kreditori ka paraqitur përgjigje në prapësim duke theksuar se debitori është regjistruar në k... në vitin 2012, që nga viti 2012 deri më tani debitori ju ka nënshtruar 29 provimeve, është studenti i vitit të tretë, për herë të fundit i është nënshtruar provimit me 17 korrik 2015 përderisa për herë të fundit pagesë në emër të studimeve e ka bërë me dtën 01 korrik 2014.

Gjykata Themelore në Prishtinë-Dega në Gllogoc, si gjykatë përmbarimore në zbatim të dispozitave ligjore konkretisht të Nenit 69 e 71 të LPP-së vlerësoi prapësimin e debitorit dhe gjeti se i njëjti është i bazuar. Arsyet e paraqitura në prapësimin e debitorit tregojnë shkaqet sikurse në Nenin 69 e 71 të LPP-së, sipas të cilave do të pengohej përmbarimi i lejuar nga përmbaruesi privat.

Gjykata ka ardhur në përfundim se përmbarimi në këtë çështje përmbarimore është caktuar në bazë të dokumentit të besueshëm - Faturës sipas Nenit 29 par.1.3 të LPP-së, por i njëjti dokument nuk i plotëson kushtet ligjore për nxjerrjen e urdhërit për faktin se, fatura me nr... e datës 12.02.2020 e lëshuar nga Kreditori nuk përmban bazën juridike për caktimin e përmbarimit siç është paraparë me Nenin 71 par. 1.4 të LPP-së dhe lidhur me Nenin 353 par. 1 të LMD-së.

Neni 71 par. 1.4 përcakton se *“sipas nenit 69 të këtij ligji, prapësimi mund të bazohen vetëm nëse: pika 1.4. ka skaduar afati kohor brenda të cilit, sipas ligjit, mund të kërkohet përmbarimi.*

Poashtu, pretendimet e debitorit lidhur me parashkrimin gjykata të njëjtat i aprovoj si të bazuara, pasi që fatura për borxhin me të cilën sipas kreditorit ngarkohet debitori është borxh i parashkruar, përkatësisht *ka skaduar afati kohor brenda të cilit, sipas ligjit, mund të kërkohet përmbarimi, këto konform Nenit 71 par. 1.4, dhe konform Nenit 353 par. 1 i LMD-së i cili nën lidhur me kërkesat periodike si në rastin konkret përmbarimor përcakton se “Kërkesat e dhënieve periodike që rrjedhin vit për vit ose në afate të caktuara më të shkurtra (kërkesat periodike), qofshin ato kërkesa periodike aksesore, siç janë kërkesat e kamatës, apo kërkesa periodike të atilla në të cilat përfundon vetë e drejta, siç janë kërkesat e ushqimit, parashkruhen tri (3) vjet nga arritja e secilës dhënie të veçantë për pagesë”.*

Gjykata gjendjen faktike të konstatuar si më lartë, i erdhi në përfundim se përmbarimi në këtë çështje përmbarimore është caktuar pa i plotësuar kushtet ligjore për nxjerrjen e urdhërit përmbarimor të paraparë me dispozitat e lartëcekura të LPP-së, për faktin se fatura mbi bazën e të cilës është ushtruar propozimi për përmbarim është i pa përshtatshëm për përmbarim, nuk

përmban periudhën e krijimit të borxhit-përkatësisht cili semestër dhe cili vit shkollor-dita kur është bërë kërkesa e kërkueshme, andaj i njëjti nuk i përmbush kushtet ligjore sipas dispozitave ligjore të LPP-së dhe të LMD-së.

Andaj, nga arsyet e cekura më lartë dhe konform dispozitave ligjore të Nenit 3, 17, 29 par. 1.3 dhe par. 3 dhe Neneve 68, 69, 71 par. 1.4 dhe 73 par. 1, 2, 3 të Ligjit të Procedurës Përbarimore, lidhur me Nenin 353 par. 1 të LMD-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË GLLOGOC**  
**Departamenti i Përgjithshëm, PPP. nr. 227/20, i datës 27.12.2023**

**Gjyqtari**  
**Astrit Gashi**

---

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa në afat prej shtatë (7) ditësh nga marrja e të njëjti, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.

Ankesa e ushtruar kundër këtij aktvendimi nuk e ndalon procedurën përbarimore përveç nëse janë dhënë garancitë për shumën e plotë të kredisë sipas Nenit 78 të LPP-së.